REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT URED PRIMIJERA OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org.Jedinice / Org. Unit: 01.7
Nr. Prot: / Broj Prot: / Prot No: 1751 / 6
Nr. i faqeve / Br. stranica / No. pages: 2
Data: / Datum: / Date: 04/09/2019
Prishtinë/a

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

***Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister***

***Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General***

---

Datë:04.09.2019
Ref:154/2019

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit,
Në mbështetje të nenit 9 dhe 18 të Ligjit Nr. 06/1 -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 07, më 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 16 (paragrafi 6 dhe 7) të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare nr. 1/18 prill 2011), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 15/2017, 16/2017, 07/2018, 26/2018, dhe Rregulloren 30/2018, dhe nenit 8 i Rregullores MF - nr – 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe Thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të datës 11.06.2019, e shpallur nga Zyra e Komisionerit për gjuhët, nxjerr:

**VENDIM**

1. Themelohet Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve të cilat kanë aplikuar në thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, në këtë përbëje:

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. Arta Pllana, | ZKGJ/ZKM | kryesuese; |
| 1.2. Besa Morina, | ZQM/ZKM | anëtare; |
| 1.3. Shaban Ademi, | ZBF/ZKM | anëtar; |
| 1.4. Gentiana Mahmuti, | eksperte e jashtme | anëtare; |
| 1.5. Dejan Dimitrijević, | ekspert i jashtëm | anëtar. |

2. Sipas nenit 8 (4) të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve anëtarë rezerve i këtij Komisoni është:

| | | |
|---|---|---|
| 2.1. Vebi Klaiqi | ZKGJ/ZKM | anëtar rezervë. |

3. Komisioni Vlerësueses nga pika 1 e këtij vendimi, kryen detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

4. Komisioni vlerësues ka mandat të shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare sipas nenit 16 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

5. Zyra e Buxhetit dhe Financave të ZKM-së do të ofroj burimet e nevojshme financiare dhe administrative për të mbështetur vlerësuesit e jashtëm konform nenit 7 të Rregullores MF-Nr-04/2017.

6. Obligohet Zyra e Kryeministrit/Zyra e Komisionerit për Gjuhët për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

**Fitim Krasniqi**

**Sekretar i Përgjithshëm - ZKM**

*Vendimi i dërgohet:*

- *Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit;*
- *Komisionerit për Gjuhët;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;*
- *Arkivit të Qeverisë.*